



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH

Numri i lëndës: 2020:028564

Datë: 12.08.2024

Numri i dokumentit: 06041844

**C.nr.27/20**

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH – Departamenti i përgjithshëm – Divizioni civil**, si gjykatë civile e shkallës së parë, nga gjyqtarja Sabaheta Kurteshi, në çështjen kontestimore të paditësit **M. S. nga fshati...**, Komuna e Dragashit, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit av. **S. B. nga Dragashi**, kundër të paditurit **V. K. nga fshati...**, Komuna e Dragashit, me objekt të padisë kompensimi i dëmit jomaterial, jashtë seance, me datë 12.08.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**HUDHËT** poshtë padia e paditësit **M. S. nga fshati...**, Komuna e Dragashit, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit av. **S. B. nga Dragashi**, kundër të paditurit **V. K. nga fshati...**, Komuna e Dragashit, me objekt të padisë kompensimi i dëmit jomaterial.

**A r s y e t i m**

Pranë kësaj gjykate është inicuar procedurë civile sipas padisë së paditësit **M. S. nga fshati...**, Komuna e Dragashit, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit av. **S. B. nga Dragashi**, kundër të paditurit **V. K. nga fshati...**, Komuna e Dragashit, me objekt të padisë kompensimi i dëmit jomaterial.

Në adresën e shënuar në padi gjykata nuk ka mundur që palës së paditur t'ia dorëzojë ftesën për seancën e datës 28.12.2023 (por edhe gjatë seancave të më parshme të caktuara), ngase fletëkthesa e gjykatës është kthyer me konstatim se i padituri është shpërngulur nga adresa e mëparshme dhe se i njëjti ndodhet në botën e jashtme, në shtetin e Italisë e në adresë të panjohur.

Kjo gjykatë ka caktuar seancën përgatitore me dt. 28.12.2023, e që në këtë seancë i autorizuari i palës paditëse av.**S. B.** është urdhëruar që gjykatës ti sigurojë adresën e saktë për të paditurin apo të propozojë përfaqësuesin e përkohshëm për të njëjtin nëse nuk gjendet adresa e të paditurit dhe këtë brenda afatit prej 15 ditësh, ose në të kundërtën padia e paditësit do të konsiderohet e tërhequr, veprim ky që është perseritur edhe me marrjen e Aktvendimit me shkrim C.nr.27/20 të dt. 12.03.2024, me të cilin aktvendim i është kthyer paditësit padia në plotësim dhe përmirësim duke cekur adresën e saktë të palës së paditur, duke paralajmëruar me pasoja procedurale nëse e njëjta nuk plotësohet dhe përmirësohet. Ndërsa edhe pse i autorizuari i palës paditëse Aktvendimin në fjalë e ka pranuar me dt. 15.03.2024 ndërsa përmes parashtrësës së datës 20.03.2024 e ka njoftuar gjykatën se adresa e përkohëshme e të paditurit nuk është e njohur, veqse është e njohur që i padituri përkohësishtë jeton në Itali në adresë të panjohur, ku njëherit i njëjti nuk ka vepruar sipas kërkesës së gjykatës.

Këtë veprim gjykata e ka ndërmarrë në kuptim të nenit 99 dhe 102 të LPK-së e duke marrë për bazë faktin se parashtrësia (padija në këtë rast) duhet të përmban veq tjerash edhe vendbanimin apo vendqëndrimin e palëve.

Gjykata vlerëson se pala paditëse brenda afatit të caktuar nga gjykata nuk e ka plotësuar dhe përmirësuar padinë sipas aktvendimit procedural dhe të shkruar, andaj në pajtim me nenin 102.3 të LPK-së, gjykata padinë e paditësit e ka hedhur poshtë.

Nga të cekurat si më lartë, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL  
2020:028564, 12.08.2024**

**G j y q t a r j a,**

---

**Sabaheta Kurteshi**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, e cila duhet të parashtrohet në afat prej 15 dite, nga dita e marrjes së të njëjtit, ndërsa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.